



**BULETIN**  
BASHKIA ELBASAN

1

KËSHILLI VENDOR I SIGURISË PUBLIKE, NË BASHKINË ELBASAN

# T'i përgjigjemi sfidave të sigurisë dhe mbrojtjes si një shqetësim parësor

NË BRENDËSI

KËSHILLAT VENDORË TË SIGURISË PUBLIKE NË ELBASAN

AKTIVITETET E KVSP-SË ELBASAN

AKTUALITET

SPORT

DOSSIER

ARTIKUJ NGA TË RINJTË

## Mesazh nga Kryetari i Bashkisë Elbasan

Të nderuar lexues:



Kur për herë të parë ngritëm mekanizmin e Këshillit Vendor të Sigurisë Publike, në Bashkinë Elbasan, mesazhi ynë ishte i qartë – *t'i përgjigjemi sfidave të sigurisë dhe mbrojtjes si një shqetësim parësor.*

Sot, kam këaqësinë që të prezantoj përpara jush buletin e parë i cili pasqyron përpjekjet e bëra nga të gjithë aktorët publikë dhe ata të shoqërisë civile, nga të rinjtë dhe rejat drejt ndërtimit të një shoqërie më të sigurt.

Veçori e këtij buletini është hapësira e kushtuar për të rinjtë dhe të rejat, të cilët kanë mundësinë të shprehin dhe ndajnë mendimet e tyre. Ata/ato i kuptojnë më së miri problemet me të cilat përballet shoqëria dhe mund të ofrojnë ide të reja dhe zgjidhje alternative.

Në këtë kontekst, buletini është një platformë në të cilën të rinjtë dhe të rejat mund të tregojnë historitë e tyre, të shprehin dhe zhvillojnë idetë dhe vizionin e tyre krijues për të ardhmen. Buletini shërben si një vend ku ata/ato janë të hapur për të parë dhe për t'u parë, për të dëgjuar dhe për t'u dëgjuar, për të lexuar dhe për t'u lexuar.

Të pajisur me aftësitë dhe mundësitë e nevojshme për të arritur potencialin e tyre, të rinjtë dhe të rejat përbëjnë një forcë shtytëse për të mbështetur zhvillimin dhe për të kontribuar për paqen dhe sigurinë. Nëpërmjet angazhimit dhe me burimet e përshtatshme, ata/ato kanë potencialin për të bërë transformimin më efektiv të shoqërisë.

Synimi ynë është nxitja e një mjedisi gjithëpërfshirës që lejon partneritet, bashkëpunim, të kuptuar të përbashkët të natyrës së kërcënimeve dhe qasjeve më të përshtatshme për t'i adresuar ato, si edhe shkëmbim të përvojave dhe praktikave më të mira në funksion të rritjes së cilësisë së jetesës.

Shpreh vullnetin për tu angazhuar personalisht me homologët, institucionet qendrore në nivel lokal, përfaqësuesit e shoqërisë civile, të rinjtë dhe të rejat, individët dhe përfaqësuesit e komunitetit për të përforcuar bashkëpunimin, përqaftuar inovacionin me besimin se përpjekjet e përbashkëta kundër sfidave që çenojnë sigurinë do të shfaqen më të forta se kurrë.

Sinqerisht,

**Gledian Llatja**

Kryetar i Bashkisë Elbasan.

## Një vështrim rreth këshillit vendor të sigurisë publike Elbasan



Kam patur kënaqësinë të punoj në Shqipëri 12 vitet e fundit, në mbështetje të përbushjes së objektivave të "Partneriteteve" të projektit RAYS, një iniciativë e mbështetur nga Qeveria e Mbretërisë së Bashkuar. Përgjegjësia ime është përqendruar në parandalimin e të rinjve të pambrojtur ose vulnerabël nga dëmtimi apo shfrytëzimi përmes punës në partneritet në të zgjeruar.

Pas pesë muajsh kërkime dhe analizash, ne vendosëm një lidhje me Elbasanin pas nisjes së projektit në Tetor 2021. *Bashkia e Elbasanit u njoh si një force udhëheqëse për ndryshim dhe na dha një mundësi për të ndarë idetë dhe për të punuar me ekipin e saj drejtues, veçanërisht kryetarin e bashkisë Gledian Llatja dhe Shefin e Stafit, Dr Ervin Muco.* Ne krijuam menjëherë një marrëdhënie pune me Këshillin Vendor të Sigurisë Publike, i cili gjatë muajve është zhvilluar në një bashkëpunim të forte dhe efektiv me kolegë në një sërë agjencish shtetërore dhe institucionesh vendore.

Ky bashkëpunim bazohet shumë në një respekt dhe mirëkuptim të ndërsjellë të kontekstit të njëri-tjetrit. Kjo qasje ka lejuar specialistët e projektit të angazhohen me profesionistë të ngjashëm në Elbasan për të hartuar dhe zhvilluar së bashku qasje që ne synojmë t'i provojmë në muajt e ardhshëm. Temat tona të punës kanë mbuluar komunikimin, vlerësimin e kërcënimit dhe riorganizimin e procesit, të cilat luajnë një rol në parandalimin e dëmit.

Në veçanti, ne po eksplorojmë modelin e funksionimit të Qendrës Mbrojtëse të Shumë Agjencie (MASH). Në një shënim personal, mirëseardhja që unë dhe ekipi i projektit kemi marrë si dhe përkushtimi për përmirësim dhe ndryshimi i treguar nga kolegët tanë në Elbasan është i jashtëzakonshëm. Nuk kam asnjë dyshim se përpjekjet tona të bashkuara do të sjellin rezultate pozitive për Bashkinë.

**Adrian Kingswell**  
Perfaqesuesi i SCJS

## 1. Një vështrim rreth këshillit vendor të sigurisë publike Elbasan



Aktualisht, rreth 55% e popullsisë në mbarë globin (4.2 miliardë njerëz) jetojnë në zona urbane. Në vitin 2050 popullsia botërore pritet që të arrijë në 9.7 miliardë njerëz dhe ajo e qyteteve të dyfishohet, ku rreth 7 në 10 persona do të jetojnë në qytet.

Autoritetet lokale janë kryesisht të parat që përballen me sfidat e sigurisë publike. Njëkohësisht, ato janë të parat

që përballen edhe me trajtimin e këtyre problematikave. Situata të ndryshme të tilla si kri mi, ndotja e mjedisit, pandemitë i vendosin në test të fortë të gjitha qytetet në mbarë botën duke ndikuar jo vetëm në shëndetin publik, por edhe në ekonominë dhe strukturën sociale.

Ngritja e mekanizmave funksionale, gjithëpërfshirës dhe të qëndrueshëm u mundëson qeverive dhe autoriteteve lokale që të ndërmarrin veprime të cilat ndikojnë zhvillimin e tyre. Koordinimi dhe bashkëpunimin efektiv midis këtyre agjencive, e ndërthurur kjo me kushtet politike dhe shoqërore të vendit përbëjnë një aspekt shumë të rëndësishëm në qasjen ndaj sigurisë publike në nivel lokal. Ngritja e makanzimit të Këshillit Vendor të Sigurisë Publike i mundëson bashkive dhe aktorë të tjerë publikë dhe të shoqërisë civile që luajnë një rol efikas në këtë aspekt.

*KVSP-të mbështesin një qasje jo-tradicionale dhe holistike ndaj sigurisë së komunitetit dhe parandalimit të krimit. Nëpërmjet këtij mekanizmi është arritur ngritja e një kulture të re të identifikimit, kuptimit dhe adresimit të shkaqeve kryesore të krimit dhe faktorëve të tjerë destabilizues në një komunitet dhe jo duke u fokusuar vetëm në vetë krimin. Kjo qasje ka nxitur dhe fuqizuar, gjithashtu, ndërveprimin midis institucioneve publike dhe jo-publike dhe komunitetit të banorëve për të kuptuar dhe adresuar më me efektivitet problematikat e lidhura me sigurinë.*

Në termat e rritjes së sigurisë dhe parandalimit të kriminalitetit Bashkia e Elbasanit ka bërë përpjekje dhe vazhdon punën e saj për rritur partneritetin dhe angazhimin e aktorëve të ndryshëm publik e jo publik, në nivel lokal e përtej. Qëllimi kryesor është rritja

e kohezionit social dhe qëndrueshmërisë së ofrimit të shërbimeve të cilat përkthehen në rritje të cilësisë së jetesës dhe sigurisë.

Në vitin 2016, nën mbështetjen e OSBE, u ngrit në Bashkinë Elbasan, Këshilli Vendor i Sigurisë Publike. Nën asistencën e IDM është dhënë një kontribut i jashtëzakonshëm në konsolidimin e KVSP-së, nëpërmjet ngritjes së spirales Bashki-Prokurori-Polici si edhe në hartimin e planit të veprimit për këtë mekanizëm.

Nëpërmjet takimeve periodike të KVSP, konferencave të përbashkëta rajonale, workshopeve dhe aktiviteteve të tjera, anëtarët e KVSP Elbasan kanë mundësinë që të ndërtojnë ura bashkëpunimi, të diskutojnë ide inovatore për politikbërje si edhe të shkëmbejnë përvojat e tyre më të mira me institucionet homologe në nivel lokal, kombëtar apo ndërkombëtar.

## 1.1 Përbërja e KVSP së Bashkisë Elbasan



KVSP Elbasan përbëhet nga: Kryetari i Bashkisë (njëkohësisht edhe drejtues i KVSP-së); Prokurori i Rrethit Gjyqësor Elbasan; Drejtori Vendor i Policisë së Shtetit Elbasan; Kryetari i Këshillit Bashkiak; Drejtuesi i Shëndetit Publik Elbasan; Drejtuesi i Shërbimit Social Elbasan; Gjykata Elbasan; ZVA; Zyra Punës dhe Aftësive; përfaqësues nga sturkturat e bashkisë (Punonjësi për Mbrojtjen e Fëmijëve; Nëpunësi

Gjinor; Emergjencat Civile; Policia Bashkiake; dhe Drejtoria e Transportit). Një përfaqësues nga media; Përfaqësues të besimeve fetare; Përfaqësues të minoriteteve; Përfaqësues të shoqërisë civile; dhe Përfaqësues të biznesit.

## 2. Aktivitetet e KVSP-së Elbasan prej krijimit të saj

Numri i takimeve të KVSP-së në vit ndryshon në përputhje me situatën e sigurisë me të cilën përballet Bashkia. Përveç takimeve të KVSP-së janë organizuar edhe takime të posaçme për trajnime, ndërtimin e kapaciteteve apo çështje të tjera të posaçme. Gjatë vitit 2022, në kuadër të funksionimit të KVSP janë zhvilluar rreth 15 aktivitete duke përfshirë: takime periodike për identifikimin dhe adresimin e problematikave (2 takime), trainime me të rinjtë Elbasan (2 takime), trainime me ndërlidhësat komunitarë (1 takim), ëorkshop me anëtarë të KVSP në nivel strategjik dhe teknik (6 takime); si edhe 4 takime për treguesit e performancës me: Drejtorinë Rajonale e Punësimit Elbasan, Shëndetin Publik, Zyren Vendore Arsimore Elbasan, Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Elbasan dhe Drejtorinë Rajonale të Policisë Elbasan).

### Projekte, Aktivitete dhe Partneritetet në Kuadër të KVSP

**IDM:** Dy-tri vitet e fundit shënojnë një bashkëpunim shumë të ngushtë midis Bashkisë së Elbasanit dhe Institutit për Demokraci dhe Ndërmjetësim (IDM) me një pikësynim kryesor "Si të arrihej që Këshilli Vendor i Sigurisë Publike të ishte sa më operacional dhe funksional, po aq edhe gjithëpërfshirës dhe i qëndrueshëm. Mbi të gjitha, çfarë duhet të ndryshonte që veprimtaria e KVSP-së të siguronte besimin e antarëve të saj dhe qytetarëve në përgjithësi". Nën drejtimin e Kryetarit të Bashkisë, Drejtuesit të Prokurorisë dhe të Policisë së Shtetit, angazhimit të aktorëve të KVSP, miratimit nga Këshilli Bashkiak i Rregullores së përditësuar mundëson gjithëpërfshirjen e komuniteteve vendore dhe sfidave të tyre të sigurisë. Dy janë arritjet më të rëndësishme të kësaj përvoje:

- Gjithëpërfshirja qytetare në ndërtimin e agjendës vendore të sigurisë;
- Partneriteti dhe bashkëpunimi horizontal i institucioneve në nivel vendor si filozofi drejtuese, dhe si praktikë funksionuese përmes planit shumaktorial vendor dhe rolit të sekretariatit koordinues. IDM do të vazhdojë të asistojë këto procese të vetë aktorëve vendorë të Bashkisë së Elbasanit.

**Grupi Palladium:** Projekti "Rilidhja e të rinjve dhe shoqërisë shqiptare" (RAYS) është një projekt i zhvilluar nga grupit Palladium në bashkëpunim me autoritetet e pushtetit qendror dhe atij vendor në Shqipëri, në konsultim me Autoritetet Shqiptare.

Ky program mbështet të rinjtë shqiptarë duke punuar me komunitetet e tyre dhe institucionet përkatëse për të ndërtuar partneritete të barabarta për të kuptuar më tej

shtytësit e angazhimit të të rinjve në krimin e organizuar serioz dhe për të nxitur rrugët alternative për të parandaluar përfshirjen e të rinjve në krimin e organizuar serioz, për të penguar përfundimisht ndikimin e grupeve kriminale si edhe për të kontribuar në ndërtimin e një shoqërie më gjithëpërfshirëse.

*Ky projekt ka 3 objektiva kryesore:*

- a. Pilotimi i programeve me të rinjtë në rrezik, në komunitetet e synuara, për të forcuar shanset dhe aspiratat e tyre për të ndjekur një aktivitet jo-kriminal: përdorimi i qasjes së bazuar në art.
- b. Forcimi i kapaciteteve të zyrtarëve vendorë për të ndihmuar në largimin e të rinjve nga krimi i organizuar serioz.
- c. Galvanizimi i partneritetit ndër-institucional për të trajtuar ndikimin e dëmshëm të kimit të organizuar serioz në nivel lokal, si dhe për të kuptuar shenjat, simptomat dhe dobësitë përmes një organizimi shumë agjencish: mbështetja dhe rritja e kapaciteteve të Këshillave Vendorë të Sigurisë Publike.

Në kuadër të këtij projekti janë organizuar tre workshope me anëtarë të KVSP: 1 në nivel Teknik dhe 2 në nivel strategjik. Qëllimi i këtyre workshopeve ka qenë të kuptuarit e qëllimeve dhe objektivave të projektit dhe se si aktivitetet e tij të mund të përshtaten më së miri me modelin e KVSP.

Gjithashtu, në muajin Prill 2002 është zhvilluar workshop 2 ditor për ngritjen e kapaciteteve të anëtarëve të Këshillit Rinor, në shkrimin e projekt propozimeve dhe menaxhimin e tyre. Në këtë workshop u trajnuan 20 të rinj të KR.

**Tjetër Vision** ka kontribuar në hartimin e planit të veprimit të KVSP Elbasan për periudhën 2017-2020 pas një procesi të gjatë konsultimi me të gjithë aktorët që veprojnë në terren. Shoqata "Tjetër Vizion" në kuadër të programit të Policimit në komunitet mbështetur nga programi SCPA ka kontribuar në Rritjen e qëndrueshmërisë dhe performancës së KVSP si dhe replikimin e eksperiencës pozitive të kësaj bashkie në bashkitë Gramsh dhe Përrenjas. Konkretisht ajo ka kontribuar në:

- Hartimin e planit të veprimit të KVSP Elbasan 2018-2020;
- Krijimin e grupit monitorues teknik multidisiplinar për monitorim dhe raportim; dhe
- Trainimi i KVSP Elbasan mbi përgjegjësitë; rolin dhe format e komunikimit dhe referimit te rasteve".

**Forumi i Gruas Elbasan (FGE)**, në kuadër të zbatimit të Planit Ndërsektorial për Parandalimin e Krimit në territorin e Bashkisë Elbasan, të hartuar nga KVSP, FGE trajton dhunën ndaj grave, vajzave dhe fëmijëve duke ofruar shërbime konkrete ndaj të mbijetuarve nga dhuna në familje dhe ajo me bazë gjinore. FGE ofron shërbime psikosociale, ligjore si edhe organizon aktivitete ndërgjegjësuëse. Në kuadër të programit "Empowerment through Self-defense" (Fuqizimi Nëpërmjet Vetëmbrojtjes) iu ofrohet të rinjve, vajza djem, nxënës e studentë mundësi për të punuar drejt zhvillimit personal, përmirësimit dhe fuqizimit të vetes.

**Dhuna në familje me bazë gjinore nika 5 e**

**Në Familje Për Familjen (NFPF):** Gjatë periudhës Tetor 2021-Prill 2022, në kuadër të projektit "Zhvillimi i qëndrueshëm nis me sigurinë publike" të zbatuar nga Shoqata Ne familje Per Familjen (NFPF) në bashkëpunim me Bashkinë Elbasan janë zhvilluar 5 trainime me tematikë "Të rinjtë për SIGURINË PUBLIKE në nivel vendor", me fokus rritjen e kapaciteteve të të rinjve mbi rolin e strukturave komunitare lokale në sigurinë publike në nivel vendor si edhe trainimi dy ditor me strukturat komunitare.

Njëkohësisht, po punohet për përcaktimin e indikatorëve që do të shërbejnë për ngritjen e databazës për KVSP.



# AKTUALITET

## 3. Panairi "Work & Study", inkurajim për punësimin e të rinjve

Bashkia Elbasan, në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit dhe Sporteve, si edhe Dhomën e Tregëtisë dhe Industrisë Tiranë, kanë çelur edicionin e 14 - të, të Panairit "Work & Study".




I kthyer tashmë në traditë, me qëllim inkurajimin e të rinjve drejt punësimit, në panair marrin pjesë shumë kompani, universitete e institucione të ndryshme, të cilat ofrojnë vende të lira pune.

Kryetari i Dhomës së Tregëtisë dhe Industrisë Tiranë, Nikolin Jaka, teksa hapi edicionin e këtij viti, theksoi rëndësinë e këtij organizimi.

Kryetari i Bashkisë së Elbasanit, z. Gledian Llatja, e sheh këtë panair si një mundësi komunikimi mes punëkërkesve dhe punëdhënësve, posaçërisht në sektorin privat.


Qëllimi i Panairit, është inkurajimi i të rinjve dhe njohja sa më afër me alternativat e ndryshme që ofrohen për punisësimin e të rinjve në të ardhmen.



Ministrja e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Evis Kushi, e cilësoi këtë Panair si një mundësi shumë të mirë për të rinjtë, kompanitë e biznesit, universitetet dhe maturantët.

# SPORT

## 4. Elbasani mirëpret sportistët Ukrainas



Kryetari i Bashkisë Z. Gledian Llatja, si edhe kreu i Komiteti Olimpik Kombëtar Shqiptar (KOKSH) Fidel Ylli, kanë pritur ekipin me 10 atletë dhe sportistë elitare nga Ukraina, të cilët janë vendosur në qytetin e Elbasanit. Atletët do të akomodohen për një periudhë të pacaktuar dhe do të stërviten në stadiumin "Elbasan Arena". Pasi i ka uruar mirëseardhjen, Kryetari i Bashkisë Z. Gledian Llatja

pohon se atletëve i janë krijuar të gjitha kushtet për aq kohë sa do të qëndrojnë në Elbasan.



Ekipi me atletë të rinj nga Ukraina, kryesisht nxënës dhe studentë, do të stërviten në pistën e stadiumit "Elbasan Arena", një nga më të mirat në vendin tonë. Në një të ardhme pritet që këtij grupi sportistësh t'i bashkohen edhe dhjetra të tjerë.

Nga ana e tyre atletët ukrainas shprehën falenderimet për mikpritjen që i është bërë në vendin tonë dhe në Elbasan ku po qëndrojnë aktualisht. Të rinjve i është

siguruar gjithçka nga Bashkia Elbasan, që nga akomodimi dhe deri tek stërvitja.

### Intervistë me sportisten Ukrainase Maria Larina

Maria vjen nga Rajoni i Donjeskut, një vatër e nxehët e luftës për një adoleshente që është detyruar të lërë vendin dhe familjen e saj nga lufta, pasi dëshiron të vazhdojë ëndrrën e saj në këtë sport. Ajo pret rikthimin sa më parë në shtëpi, me luftën që shpreson të marrë fund sa më parë.

### *Si ndiheni këtu?*

Ndihemi mirë. Vendi juaj është shumë i bukur dhe na pëlqen gjithçka kemi parë këtu. Jemi të lumtur, pasi tani kemi edhe një mundësi për t'u stërvitur dhe nuk na mungojnë kushtet.

### *Erdhët menjëherë në Shqipëri apo shkuat edhe në vende të tjera më parë?*

Ishim në Ukrainë dhe nga aty shkuan në Varshavë, Poloni. Më pas erdhëm në Shqipëri dhe ja ku jemi tani këtu.

### *E njihnit Shqipërinë më parë?*

Kisha lexuar dhe marrë informacione nga interneti më herët, edhe për faktin se më pëlqen deti dhe malet dhe ky vend i ka ato. Më pëlqen edhe të udhëtoj dhe më vjen mirë që jam në Shqipëri.

### *Sa e rëndësishme është për ju stërvitja?*

Është shumë e rëndësishme të vijojmë stërvitjen, sepse unë jam pjesë e Ekipit Kombëtar të Ukrainës dhe ne kemi nevojë të vazhdojmë stërvitjen. Sezoni i garave po afron dhe ne duhet të përgatitemi për Kampionatin Botëror dhe atë European.

### *Kur mendoni se mund të ktheheni në shtëpi?*

Ne duhet të kthehemi në shtëpi. Ne duhet ta ndalojmë këtë luftë sepse shumë njerëz po humbin jetën dhe është shumë e tmerrshme, e rrezikshme. Por edhe nëse duhet të stërvitemi, ne duhet të kthehemi në Ukrainë.

### *Si është familja juaj, keni folur me ta?*

Unë jam nga Rajoni i Donjeskut dhe atje është shumë situatë e nxehtë. Mamaja dhe gjyshja ime janë në shtëpi. Nëse unë dëshiroj të lëviz nëpër botë, nga ana tjetër gjyshja ime dëshiron të qëndrojë në shtëpi. Është 72 vjeçe dhe e do shumë Ukrainën, ndaj dëshiron të qëndrojë atje.



## 5. Histori suksesi: dy motrat sjellin biznesin e luleve në qytetin e luleve



Nisma "Elbasani Rritet" e cila synon të promovojë modelet më të mira rinore, të mbështesë dhe fuqizojë ato, vendosi këtë rradhë të vizitohet Artenisa Daci dhe motrën e saj Rominën.

Dy vajza të reja në moshë, vendosën që tashmë lulet të mos i shohin vetëm në oborre shtëpishë, apo në lulishte të qytetit, por ti ndejnë ato në çdo moment. Me iniciativën e tyre, me forcën rinore që i karakterizon, ato ndërmorën hapin e sigurtë në vetvete, të bënë biznes. E ku ka më bukur, të tregëtosh lule, në Elbasan, qytetin e luleve.

Ideatori i nismës Alban Shingjergji, realizoi një intervistë me dy motrat,

të cilat i gjen çdo ditë në ekspozitën e hapur, ku në çdo cep të shoh syri vetëm lule shumëngjyrëshe, dhe pasionin e dy vajzave të reja për lulet.

### *Artenisa, si lindi dëshira për të hapur këtë biznes?*

Isha e vogël, nëna dhe mami ishin shumë të apasionuara për lulet, sadisfaksion që e përcolla edhe unë. Ishte pasioni që kisha për lulet ai që, me kalimin e viteve, nuk mund të rrija dot pa to. Krijoja buqeta, dhe i dhuroja ku të mundja lulet.

### *Vetëm pasioni?*

Po, i ndoqa lulet deri në Hollandë, ku edhe realizova dëshirën time duke kryer një kurs vetëm për artin e kompozimit të luleve, e për t'u rikthyer në Shqipëri të hap këtë biznes që kam.

### *Romina, po ju?*

Unë kam mbaruar studimet për Menaxhim, dhe puna ime në biznesin tonë është menaxhimi, jo vetëm vizual por edhe virtual, duke e shtrirë biznesin edhe on - line. Lulet janë të gjitha natyrale, lulja jeton përjetë, dhurata më perfekte që mbetet në mendjen e çdo njeriu që ka fatin ta marrë.

### *Artenisa, a duhet të kesh pak shpirt arti për këtë biznes?*

Po, sigurisht. Mbështjellja e luleve ka rëndësi, Ngjyra e luleve të shumëllojshme, kombinimi i ngjyrave, të gjitha së bashku krijojnë buqetën, e cila duhet të qëndrojë gjatë në mendjen e çdo klienti që e merr dhe më pas e dhuron.

Vajzat kanë talentin të kombinojnë ngjyrat, ku sipas tyre ngjyra lejla dhe ngjyra rozë janë kombinimet perfekte, madje edhe qytetarët elbasanas i kërkojnë shumë. Artenisa, i quan lulet e shpresës, të thurura në një kurorë. Detajet kanë shumë rëndësi, prandaj dy motrat përpiqen që të ecin me trendin e kohës.

### *A kanë dëshirë elbasanasit të blejnë lule?*

Po, lulja tashmë është një nga dhuratat më të rëndësishme si në raste gëzimi, ashtu edhe hidhërimi

Vazot qeramike, të kombinuara me lule shumëngjyrëshe, vazhdojnë të jenë preferencë e luledashësve, vlen të përmendim trëndafilin, lulen "magjike", apo edhe lule diellin, etj.

Edhe pse të reja në moshë, buqetat me lule të sjella me mjeshtëri nga duart e dy motrave të reja nga Elbasani, vazhdojnë të mahnisin të gjithë të apasionuarit pas luleve. E bëjnë me pasion punën e tyre, dhe besojnë se kanë sukses pasi kanë besimin dhe shpresën tek puna, dhe më së shumti tek dashuria e luleve.



## 6. “Lëvizja olimpike”, kampionati për të rinj, risi për qytetin



Bashkia e Elbasanit në bashkëpunim me Zyrën Vendore të Arsimit në Elbasan, përgjatë disa javëve organizoi një mini kampionat midis shkollave 9-vjeçare dhe të mesme të qytetit në kuadër të “Lëvizjes Olimpikë”.

Ky aktivitet, një risi në këtë qytet, i cili ka në focus të rinjtë, solli masivizimin e sa më shumë nxënësve, të cilët konkuruan në disa disiplina të ndryshme sportive.



Një organizim i arrirë, i cili rezultoi brenda të gjitha pritshmërive, me talentet e reja që treguan vlerat e tyre në fushën e sportit. Në këtë aktivitet morën pjesë 8 shkolla 9-vjeçare dhe 8 të mesme dhe duke parë performancat pozitive synohet që të kthehet në një aktivitet të përvitshëm nga ana e bashkisë së Elbasanit.

Ekipi fitues në basketboll për femra u shpall “IMSA”, e cila mundi në finale “Kostandin Kristoforidhin” me rezultatin 43-14, ndërsa për meshkuj fitues u shpall “Kostandin Kristoforidhi” që mundi në finale “Dhaskal Todrin” me rezultatin 39-23. Në volejboll për femra kampion u shpall “Luigj Gurakuqi” që mundi në finale “Dhaskal Todrin” 2-0. Ndërsa në volejboll për meshkuj, “Dhaskal Todri” mundi “Onufrin” me rezultatin 2-0.

## 7. AF Elbasani, një histori suksesi. Shpallet kampion i kategorisë së tretë



Më 2 gusht 2021 në ambientet e kompleksin sportiv "Shefqet Lamçja" zbriti në fushë ekipi më i ri i futbollit në qytetin e Elbasanit, Akademia e Futbollit Elbasani. Në këtë seancë të parë stërvitore i pranishëm ishte edhe kryebashkiaku Gledian Llatja, i cili premtoi mbështetjen e tij dhe institucionit që drejton. Një klub që u krijua nga fillimi, pas një mbledhjeje të Këshillit Bashkiak, ku në mënyrë unanime këshilltarët vendosën që të rigjallërojnë futbollin në këtë qytet, me synimin për të rikthyer ngjyrat verdhë e blu aty ku e kanë vendin, në elitën e futbollit shqiptar. Në sezonin e parë skuadra mori pjesë në Kategorinë e Tretë, teksa në pankinë u emërua një emër i njohur i futbollit shqiptar si Gentian Stojku.



Në një kohë shumë të shkurtër u afruan edhe lojtarët që do të përfaqësonin këtë skuadër dhe frytet e punës u panë që në muajt e parë. Ekipi nisi me serinë e fitoreve të thella, duke treguar diferencat me rivalët. Pa u mbyllur ende kampionati, AF Elbasani siguroi matematikisht edhe ngjitjen në Kategorinë e Dytë dhe sezonin e ardhshëm do të luajë në këtë ligë. Verdheblutë e mbyllën sezonin me 40 pikë pas 14 ndeshjesh, me

një bilanc prej 13 fitoresh dhe një barazim, me 86 gola të shënuar dhe vetëm 4 të pësuar. Ky ishte trofeu i parë i skuadrës në pak muaj krijim, duke marrë edhe përgëzimet e kryebashkiakut Gledian Llatja, i cili premtol mbështetjen e tij maksimale edhe në vijim. Pritshmëritë për sezonin e ardhshëm janë të mëdha, pasi do të ndërhyhet në merkato dhe synimi i këtij klubi do të jetë ngjitja në Kategorinë e Parë, me objektivin e vetëm që në të ardhmen e afërt ekipi i AF Elbasanit të shkojë aty ku e meriton, mes më të mirëve të futbollit shqiptar.



# DOSSIER

## 8. Qyteti që u pagëzua nga tre perandorë

Interesi që po ngjall ndër vizitorët e huaj kalaja fushore e Elbasanit, pa dyshim ka të bëjë me origjinën Romake të saj.

Kjo kala imponante e ngritur mbi kalldrëmin e rrugës perandorake Egnatia, në harkun e 1200 vjetëve është pagëzuar nga tre perandorë të shquar të historisë, Diokleciani, perandori Romak me origjinë Ilire, Justiniani i Parë Bezanin nga Bederiana pranë Prishtinës, dhe sulltani më i famshëm i turqve Osmanllinj Mehmet Fatih Ngadhnyjesi. Lindjen, zhvillimin dhe rrënimin përfundimtar Skampini ua detyron të njejtit faktor "Rrugës Egnatia".

*"Në kohën e Perandorisë Romake ndërtimi i saj u bë burim mirëqenie e lulëzimi, kjo, jo vetëm për Skampinin, por për krejt krahinën rreth e rrotull, ndërsa në vigjiljen e dyndjeve të popujve e në vazhdim të tyre, ajo u shndërrua në një shkak mjerimi të pandërprerë".*

Këto fjalë monumentale të arkeologut dhe historianit Hasan Ceka shpjegojnë qartë edhe arsyen e ndërtimit të kalasë së Elbasanit, ose "Castrum Scampinus", sic quhej në epokën e Perandorisë Romake. Kjo fortesë përfaqëson një castrum statum, për strehimin e një legjioni romak që do të shërbente për ruajtjen e sigurinë e rrugës Egnatia.

Vetëm një fuqi e tillë si shteti romak mund të kishte sigurinë e ndërtimit dhe qëndrueshmërisë së një kalaje fushore. Paraardhësit tanë i ndërtonin kështjellat në maja shkrepash të mbrojtura nga natyra, ndërsa romakët ndiqnin parimin "Kalatë i mbrojnë burrat, jo muret!".

Në të gjithë gjatësinë e rrugës Egnatia, ndihen vlerat monumentale dhe autoriteti i fuqisë së tyre. Megjithëse rruga Egnatia përmendet nga Straboni 120 vjet para Krishtit, kalaja e Skampinit filloi të ndërtohej në vitet 285–305 para Krishtit dhe mori formën e plotë nga rindërtimi i perandorit Justiniani i Parë, në vitet 530–565 pas krishtit. Shumë kohë para se të ndërtohej ky fortifikim filloi jetën qyteti i Skampinit, në fillim rreth stacionit Mansio të rrugës Egnatia e më pas u çvendos në luginën e gjerë midis dy përrenjve të Zaranikës dhe Manasderes. Në dokumenta të mëvonshme emri i qytetit të lashtë do të marrë trajta të ndryshme. Sipas gjuhës që përdorin kumtuesit e tij dokumenti më i rëndësishëm dhe më autentik për vendodhjen e qytetit dhe formën e emrit, është guri i varrit të Legjiniarit Mark Sabidi që ndodhet në Muzeun Etnografik të qytetit. Ky gur ka të gdhendur emrin e





qytetit në formën e shkurtuar "Skam", dhe u zbulua në vitin 1922 në gërmadhat e një ndërtese që gjendej mbi portën jugore të kalasë. Emri i gdhendur në gurin e Mark Sabidit përkon me hipotezën e gjuhëtarit gjenial Georg Von Hanh i cili në vitin 1853 është i pari dhe i vetmi që e lidh emrin e qytetit me fjalën shqipe Skampa. Kalaja fushore e Skampinit të lashtë ka formën e një katërkëndëshi këndrejtë me përmasa 308 x 348 metra, e orjentuuar në drejtim verilindje – jugperëndim.

Ajo ka katër hyrje të cilat mbrohen nga kulla. Në katër qoshet e saj gjenden kullat e mëdha që mendohet të kenë qenë 12 metra të larta në ndërtim. Kështjella është e pajisur me 26 kulla që gjenden 40–50 metra larg njëra tjetërs. Ajo qarkohej nga një hendek tre metra i thellë që mbushej me ujë nga përroi i Zaranikës. Muri i periudhës së vonë romake gjendet në të gjithë gjatësinë e mureve. Ai ngrihet mbi nivelin e themeleve dhe ruhet në lartësinë 5 metra. Trashësia e murit rrethues është tre metra. Ai është ndërtuar me teknikën "opus mixtum" me katër rreshta tullash në brez. Kjo ndërthurje shërben për të realizuar një lidhje më solide midis pjesëve të murit. Nga punimet e kryera në brendësi të murit jug – perëndim të kështjellës del në pah një lartësi muri prej 9 metrash. Në gjendjen e sotme të kalasë mungojnë plotësisht hyrjet kryesore të kështjellës ose siç quheshin nga romakët portat "dekumanus".

Porta që egziston sot është vetëm një hyrje sekondare që përfaqëson drejtimin veri-jug. Portat kryesore të drejtimin perëndim - lindje nëpërmjet të cilave kalonte rruga Egnatia, gjendeshin ndërmjet dy kullave në formë U – je, të dala gjysëm jashë murit rrethues. Ka pasur dy porta të jashtme dhe të brendshme dhe midis tyre një oborr katërkëndësh me përmasa 1x10 metra. Mendohet se brenda rrethimit të kalasë, veç ndërtesave publike të ketë pasur edhe dy katedrale paleokristiane. Në vitin 1466 sulltan Mehmet Fatihu urdhëroi rindërtimin e mureve gërmadhe të Skampinit antik, "të quajtur tani qytet". Kalaja e rindërtuar që shërbeu së pari si garnizon ushtarak, u emërtua nga turqit II - bassan, por populli duke mos u pajtuar në fillim me emrin e huaj e quajti Qyteti i Ri. Në tekstet kishtare të kishës së Shelcanit ai quhet Neokastron.

Në dokumenta italiane ai quhet herë Terranova herë Çitanuova. Vetëm nga mesi i shekullit XVIII emri "Qyteti i Ri" bie në harresë dhe filloi të përdoret emri Elbasan.

E megjithatë populli i kësaj treve nuk e humbi krejt kujtimin e qytetit antik të Skampinit duke e përjetësuar, atë në emrin e lumit Shkumbin. Por edhe një kodër në jug të urës së Shkumbinit ku janë gjetur rrënoja antike, mbante emrin qytezë, deri sa brezi ynë e harroi.

Në vitin 1899 në një nga kullat e kalasë në pjesën jugore u ndërtua edhe kulla e sahatit që është ende edhe sot në gjendje pune dhe krenari i qytetit që e ka.

Ajo ngrihet e lartë si simbol i Elbasanit dhe që është mirëmbajtur jo vetëm si kullë që është në gjendje të mirë, por edhe mekanizmi i sahatit të tij.

# ARTIKUJ NGA TË RINJTË

## 9. Riciklo të tashmen shpëto të ardhmen!

*Olsjana Haskja*

Prej 10 vitesh gjimnazi “Kostandin Kristoforidhi” është pjesë e rrjetit të shkollave që zhvillojnë modulet e ofruara nga Junior Achievement of Albania, në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit dhe Sportit dhe AADF.

Në kuadër të këtij bashkëpunimi janë ofruar gjatë gjithë kësaj kohe, si pjesë e kurrikulës shkollore modulet: Drejtues për një ditë, Bëhu sipërmarrës ose kompania e Nxënësve, Etika e Biznesit, Aftësi për sukses. Ndër vite, në këto module janë përfshirë 923 nxënës, të cilët, kanë marrë pjesë nëpër konkurse kombëtare dhe ndërkombëtare. Pjesëmarrja e tyre i ka sjellë shkollës me dhjetëra çmime të fituara në sajë të punës dhe drejtimit të mësueses Shkëndi Xhyra, e cila, nga ana e saj, është gjithashtu fituese e çmimit “Mësuesi i vitit JA Albania 2021” dhe e nominuar për çmimin “JA Europe Teacher of the Year Aëard 2021”.

Nga ku mund të përmendim kompanitë: Arts and Plants e cila u vlerësua me çmimin “Plani më i mirë i marketingut” e cila gjithashtu përfaqësoi Shqipërinë në Festivalin e Madh European COYC 2021 (JA Europe) dhe kompanitë Diviola, Molekulë Air, Epilepsy Care dhe Office Green

### “Office Green”

Synimi i “Office Green” është krijimi i një koshi riciklimi inteligjent. Duke ditur që një nga problemet kryesore në vendin tonë por edhe në botë është ndotja e mjedisit e cila është shkaktare e fillimit të një zinxhiri të gjatë problematikash (ngrohja globale, sëmundjet, zhdukjen e habitateteve dhe gjallesave ...) dhe mënyra më efikase për parandalimin e këtij fenomeni është riciklimi Office Green.

Krijimi i këtij koshi riciklimi inteligjent realizuar nga nxënësit e klases 11 -G të gjimnazit “Kostandin Kristoforidhi” do të mundësonte:

- Grumbullimin efikas të mbeturinave në burim;
- Bën më të lehtë procesin e riciklimit;



- Ka një përdorim të gjerë (administratë, shkolla, ambiente publike...);
- është më ekonomik (çmimi)
- Nuk zë shumë hapësirë

Koshi i riciklimit inteligjent do të ketë përmasat: gjatësi 1m dhe gjerësi 1 m në formën e një cilindri "gjigand" (përmast mund të ndyshojnë në varësi të mjedisit ku do të përdoret) e nga ku materiali i koshit do të jetë metal

Koshi i riciklimit inteligjent do të jetë i ndërtuar në 3 pjesë kryesore:

1. Koshi: Koshi i riciklimit do të ketë formën dhe përmasat si me lart, gjithashtu do të ketë në brendësi dhe 4 kosha të tjerë të cilët do të korespondojnë me 4 kategoritë e riciklimit (leter, qelq, plastike, dhe mbetjet ushqimore), të cilët do të bëjnë të mundur lehtësimin e procesit të riciklimit dhe grumbullimin efikas të tyre.
2. Kapaku i koshit: Kapaku i koshit do të ketë përmasat: gjatësi: 1m, gjerësi: 1m. Funksioni kryesor i kapakut do të jetë mbyllja hermetike (e cila mundëson mos përhapjen e mbeturinave në ambientet private ose publike nga kafshët ose era) gjithashtu do të shërbejë si mbajtëse e 4 butonave.
3. Mekanizmi: Secili nga butonat e vendosur tek kapaku do të korespondojë me 1 nga ndarjet (koshat brenda koshit të madh). Në momentin që ne duam të riciklojmë letrën shtypim butonin që i përket ndarjes që do të mbaj letrën dhe në atë moment mekanizmi bën të mundur që "ndarja" e letrës të pozicionohet dhe ju t'i hidhni mbeturinat në koshin përkatës (ky proces do të jetë për secilin nga kategoritë e riciklimit).

Riciklo të tashmen shpëto të ardhmen!

Jeta dhe riciklimi nuk kanë çmim prandaj riciklo që jeta jote të mos ketë një çmim të cilin do të jetë tepër vonë për ta paguar!

## 10. Një vit pa sfida për të gjithë botën vështirë se mund të gjendet

TË RINJTË, SOLIDARIZOHEN PËR PROBLEMET SOCIALE NË QYTET

*Fabjola Musta*

Duke filluar nga ato sfida që lidhen me shëndetin e duke vazhduar deri tek ato që çenojnë vetë paqen, gjithçka merr përmasa kaq të mëdha sa bashkimi i të gjithëve ne nuk mbetet më një zgjedhje, por kthehet në të vetmen zgjedhje.

Por këtu në Elbasan solidariteti i treguar për çdo kauzë që ka nevojë për reagim të menjëhershëm nuk mungon dhe një nga faktet që dëshmon për këtë është të pasurit qindra të rinj vullnetarë në organizata të ndryshme me fokus në problemet sociale në qytet, në Shqipëri apo dhe në të gjithë botën.

Nëse ndalemi pak më konkretisht në angazhimin e të rinjve vullnetarë në aktivitetin e Kryqit të Kuq Elbasan, shohim padyshim pjesëmarrjen e gjërë në fushatat e ndërmarra për një sërë kauzash. Duke filluar nga emergjencat natyrore ku mund të përmendim tërmetin e 26 nëntorit, një ngjarje aq e dhimbshme për të gjithë shqiptarët, por që na bashkoi fort dhe vullnetarët tanë ishin aty, si në fushatën e mbledhjes së ndihmave po ashtu edhe në zonat e prekura, krahas ekipit të mrekullueshëm nën emrin e kësaj organizate kaq të rëndësishme. Për të vazhduar me probleme që përfshinë të gjithë botën siç ishte pandemia, ku ndihma e grupmohës më të rrezikuar, të moshuarve, kaloi në prioritetin kryesor, dhe ku përpjekjet për të ndihmuar nuk ndaluan kurrë, ndonëse situata nuk ishte aspak e lehtë. E duke arritur deri në fushatat e ndërmara në raste të përshkallëzimit të konflikteve mes dy ose më shumë shteteve e duke rezultuar në luftëra, marrë shkas dhe nga zhvillimet e kohëve të fundit, fushata që kanë në qendër mbledhjen e ndihmave për zonat e prekura dhe së cilave iu bashkuan shumë qytetarë.

Por nuk janë vetëm raste emergjencash natyrore apo problemesh globale situata që kërkojnë vëmendje. Pavarësisht zhvillimeve të tjera, Kryqi i Kuq ka ndërmarrë një sërë projektesh me fokus në problemet sociale në komunitet, duke i dhënë mundësinë të rinjve për të pasur një impakt të drejtpërdrejtë në jetët e shumë individëve. Ndër disa prej tyre mund të përmendim projektet që mundësonin vakte në ambjentet e organizatës për njerëzit në nevojë apo pako ushqimore për këta individë. Një tjetër projekt i ngjashëm që po vijon aktualisht ka në qendër shumë të moshuar të cilët do të mbështeten me ndihma ushqimore çdo muaj përgjatë një viti. Një projekt që me koordinatoret,



vullnetarët dhe të moshuarit ka sjellë bashkë tre gjenerata dhe që mbetet një ndër më të dashurit prej të gjithëve.

Ndonëse secila nga nismat e përmendura më lart mbetet jetike në mënyrë indirekte, gatishmëria që cdo qytetar i Elbasanit tregon për të kontribuar në fushatat e marra nga organizata të shumta e që kanë në qendër mbledhjen e fondeve për kurimin e njerëzve që e kanë të pamundur ta përballojnë atë, ose për operacione që nuk mund të kryhen brenda vendit mbetet një ndër faktet që na bën më së shumti krenarë për komunitetin tonë. Me dhjetëra vullnetarë që punojnë për këto fushata, me dhjetëra mijëra qytetarë që nuk hezitojnë të kontribojnë dhe me aq shumë raste ku këto fushata kanë shpëtuar jetë. Humanizmi që karakterizon shqiptarët dhe që qëndron thellë në identitetin tonë është një ndër arsyet e krenarisë që vjen bashkë me të qenurit qytetar i këtij qyteti.

Sot është e pamundur të mos jesh në dijeni të zhvillimeve negative në komunitetin ku jeton apo në botë. Shpeshherë ndikohemi nga kjo dhe fillojmë të mendojmë se humanizmi ka vdekur. Por janë pikërisht raste të tilla, ku njerëzit nuk i lëshojnë dorën njëri tjetrit, ato që të bëjnë të besosh sërish, ato që të ngrohin zemrën e të bëjnë krenar. Të bëjnë të kuptosh se sa fat është të jesh pjesë e një komuniteti të tillë, ku të gjithë do të jenë aty për këdo që ka nevojë dhe ku kjo ndjenjë e unitetit dhe dhembshurisë për të tjerët, që është trashëguar ndër breza, do të vazhdojë të trashëgohet edhe nga të rinjtë sot që përpiqen të bëjnë ditën e dikujt më të bukur. Sepse një vit pa sfida për të gjithë botën vështirë se mund të gjendet, por ne jemi gati për të kapërcyer secilën prej tyre, duke mbajtur dorën e secilit, për të kapërcyer gjithçka.



## 11. “A mund të zëvendësohet shkolla fizike me atë online?”

*Alem Bedhija*

Shkolla është një ndër ato formula klasike që përgjatë shekujve ka treguar se është funksionale, efikase dhe se nuk ka nevojë për ndryshime radikale, por kohët e fundit, frymëzuar edhe nga epoka në të cilën po jetojmë, një debat i madh publik është hapur në lidhje me çështjen se a duhet të zëvendësohet shkollimi klasik fizik me atë online dhe se a ka efekte të njëjta, në mos anësore (për mirë apo për keq) ky lloj shkollimi.

Unë mbroj tezën se shkolla dhe shkollimi fizik janë një mënyrë e pacënueshme e edukimit të individit dhe si e tillë, ajo duhet vetëm të pasurohet dhe “krasitet” për tu përmirësuar, por kurrësesi të zëvendësohet me shkollën online. Vetë shkolla një ndër funksionet e saj ka socializimin e nxënësit, pra, ajo nuk kujdeset vetëm për përçarjen e anës akademike, por bën të mundur edhe krijimin e një individit që në të ardhmen të dijë të pozicionohet në shoqëri, mes shokësh dhe të përshtatet me karaktere e tipe të ndryshme njerëzish. Në sytë e mi, aspekti i shoqërizimit dhe formimit njerëzor është argumenti më i madh bindës pse shkolla dhe shkollimi fizik nuk duhet çuar ndërmend të zëvendësohen.

Nga ana tjetër, procesi i mësimdhënies, vetë kurrikula shkollore është e projektuar të zhvillohet nën kontaktin fizik, pamor dhe bashkëveprues të nxënësit, mësuesit dhe shkollës. Mund të krijohen dhe ngrihen të tjera kurrikula, por vetë procesi i mësimdhënies është i tillë që kërkon nxënësin përpara mësuesit për të arritur 100% të efektshmërisë kur është i mirëzhvilluar apo i mirëplanifikuar. Është e vërtetë se jo çdo shembull i mësimit fizik është histori suksesi, por përjashtime ka dhe do të ketë gjithmonë. Ajo çka na intereson neve është fakti se përqindja më e lartë e individëve që kontribuojnë në shoqëri duke ushtruar profesionin e tyre, kanë dalë nga dyert e shkollës dhe janë pinjollë të mësimit fizik. Ka më shumë se 3000 vite që koncepti i edukimit lidhet me ndërveprimin fizik të individit dhe historia ka treguar se ky koncept i tillë zhvilluar ka pasur efikasitet, ndaj dhe nuk ka arsye pse të ndryshohet. Është provuar statistikisht dhe jo vetëm, se janë metodat e mësimdhënies fizike sy më sy ato që i bëjnë nxënësit të përftojnë dhe të kuptojnë më shumë.

Nga ana tjetër, ka dhe partizanë të mësimit online. Këta bazohen tek disa argumente të pakta ku ai më bindësi është se e ardhmja po shkon drejt kësaj rruge, por duhet të kundërshtoj duke thënë se nëse njeriu po shkon drejt një rruge ku ndërveprimi social midis individëve që ndikon tejmasë në shëndetin mendor dhe atë moral të njeriut, do të



zëvendësohet me ndërveprimin e akullt midis individit dhe inteligjencës artificiale (sado të këmbëngulin, sado të zhvillohet, kjo inteligjencë kurrë nuk do të mund të arrijë impaktin e njëjtë tek njeriu, për arsye të thjeshtë se përveç neuroneve, trupi funksionon dhe nëpërmjet hormoneve), e ardhmja në gjykimin tim është e errët. Arsyeja e dytë është se sipas tyre mësimi online është një lloj efikas që jo vetëm nuk është e vërtetë, por mjafton të pyesësh një nxënës së filltores se si arrin të kuptojë më shumë për të kuptuar se ky argument është kryekëput absurd. Si mund të punosh në laboratorë online? Si mund të luash në skenë online? Si mund të bësh vrap online? Thjesht s'mundesh dhe ky është fakt.

Ndër të tjera, mësimi online do të kontribuonte edhe në krijimin e gjeneratave më anti-sociale që do të kishim dëshmuar ndonjëherë. Njeriu ka nevojë të kuptojë që në vegjëli se jo çdo gjë bëhet vetëm.

Për këdo që ka ngelur i ngërthyer në idetë futuriste të filmave fantashkencë, mjaft të kuptojnë se dhe ato janë ide të përsëritura. Po të ishin realizuar, do duhet të jetonim në të tilla kushte që prej fillimit të shekullit XX. Zhvillimi teknologjik, ashtu si popullsia rritet me ritme eksponencialisht progresive, ndaj ka kohë për të diskutuar, por duhet të kuptojmë se shkolla fizike nuk ka simotër.

## 12. Jeta, liria, kërkimi i lumturisë

*Alem Bedhija*

Pse jeta nuk konsiderohet e plotë pa lirinë dhe lumturinë?

Mos ndoshta është lumturia që na fal lirinë, apo të qenit të lirë na sjell në gjetjen e lumturisë? Është fare e thjeshtë të pohojmë se nëse nuk ekziston njëra, tjetra do të ekzistojë pjesërisht, por a mund të themi se midis lirisë dhe kërkimit të lirisë ekziston realisht një ekuacion që formulon kuptimin e jetës?

A ekziston lumturia, apo është vetëm një iluzion? Unë mëndoja se lumturia nuk ekziston, por ekzistojnë copëza lumturie. Pra, a mund të themi se jemi të lumtur vetëm kur përjetojmë copëza lumturie? Them se po, por nga ana tjetër, a do të thotë kjo se lumturia ekziston pjesërisht? Sigurisht që po. Pra, nëse ndjekim rastin e parë, për sa kohë lumturia na çon tek liria dhe përderisa lumturia ekziston pjesërisht, do të thotë që edhe liria ekziston pjesërisht, pra ne jemi të lirë vetëm për pak momente. Sigurisht që jo. Pse? Sepse liria është relative. Dikush mendon se jeton me lirinë gjatë gjithë kohës, dikush tjetër mendon se liria nuk arrihet dhe duhen kaluar perpiecira fizike, shpirtërore dhe shoqërore për ta arritur. Pra, e pranojmë se liria është iluzion? Sigurisht. Shpjegoje. Ja, në paragrafin tjetër.

Kush na thotë se në botë jemi të lirë? Me të vërtetë, ke para dhe ha, pi, ke një strehë mbi kokë, por paraja nuk është e përhershme. Po kur parja fillon e rrallohet, a ndihesh njëllë i lirë? Normalisht që jo. Kjo ndodh për arsye se çdo njeri rrit brenda vetes konceptin e vet të lirisë. E nëse punon aty ku ti do, a je i lirë? Po? Unë them jo! Them jo se edhe nëse ti punon aty ku do, ti prapë punon, pra liria jote kushtëzohet nga detyrimi për tu shteruar që të fitosh lirinë. Pra, liria është një koncept relativ, tejet abstrakt që tek secili prej nesh ka emër të përveçëm.

Pra as lumturia, as liria nuk u lidhkan me jetën? Lidhen, si jo?!

Meqë lumturia ishte e gënjeshtërt dhe liria ishte iluzion, ne e kemi në dorë vetë për të krijuar një iluzion të gënjeshtërt për të ndërtuar jetën e cila si pa kuptuar, hedh rrënjë në një liri asnjehërë të sigurtë, ideja e së cilës na lumturon.

Pra jetën e ndërtojmë mbi bazën e iluzioneve dhe gënjeshtërave? Jo. Po a thamë që ne e kemi në dorë vetë për të krijuar një iluzion të gënjeshtërt për të ndërtuar jetën? S'ka lidhje.





S'ka lidhje pasi shoqëria është aty për ta stabilizuar këtë iluzion, për ta futur atë në një kurth fjalësh dhe marrëveshjeje që e bejnë lirinë të vlefshme për aq kohë sa ajo sigurohet nëpërmjet interkativitetit shoqëror.

Pra, jeto i lirë duke punuar për shoqërinë? Po. Po a nuk humbet karakteri iluziv i lirisë kështu? Jo, pasi nuk ka iluzion më të madh se ky: të varesh nga tjetri që varet nga ti, pa e pasur të sigurt se kjo marrëdhënie varësie njëanshëmrisht shfrytëzuese do të ekzistojë në mënyrë të përhershme. Dhe për më tepër mendimi se e kemi këtë siguri që na krijon liria na sjell lumturi?

Me pak fjalë, ne jemi të lindur për të qenë të lumtur në iluzionin tonë të lirisë? Jo detyrimisht, ka njerëz që e fitojnë lirinë e vërtetë kur kushtëzojnë lirinë e tjetrit. Po a janë të lumtur ata? S'di të them, se kam provuar. Di të them se jam i lumtur, pasi e kam lirinë për të punuar për mendjen time që nesër do të bëjë goxha punë për shoqërinë.

Një filozof ka thënë: "Karakterit yt është diçka që ti zgjedh vetë që ta krijosh". A i ndërtojmë vetë cilësitë e karakterit apo ai formohet nga ndikime që s'mund t'i kontrollojmë dot? Po ju si mendoni?

Na pëlqejmë të mendojmë se karakteri është një vlerë që na përfaqëson denjësisht midis njerëzve, midis të tjerëve. Karakteri është krenari, mangësi, madje edhe dobësi. Shpesh dëgjojmë të thuhet se njerëzit vlerësohen në bazë të karakterit të tyre, se karakteri tregon realisht thelbin e një njeriu. A është karakteri në të vërtetë dhuratë, apo një tipar i mësuar?

Unë i përkas atij grupi, i cili mendon se karakteri është diçka e lindur, por që kurrsesi nuk mund të formësohet plotësisht pa ndikimet dhe influencat e nevojshme, të mira a të këqija qofshin. Ka njerëz që përpiqen ta shpjegojnë karakterin nëpërmjet universit, si një tipar që i përgjigjet llogaritjeve astronomike, të tjerë e shohin atë si një tipar që lidhet me trashëgiminë, ka dhe nga ato që preferojnë të mendojnë se karakteri është thjeshtësisht fat, por unë nuk mendoj kështu.

Më pëlqen të mendoj se karakteri është një tipar që njeriu e mbart me vete që nga fillimi, pjesërisht të fshehur, derisa vjen ai moment që ndikimet e jashtme janë aq të forta sa karakteri shpërfaqet i plotë. Jam gjithashtu i mendimit se karakteri injektohet, dhe sado klishe të tingëllojë ai mësohet në vegjëli. Në, si qenie unike shpërfaqim cilësi dhe virtyte të caktuara që na dallojnë dhe ragimi ynë kompleks kundrejt jetës është ai që na definon karakterin. Ndaj them se karakteri është diçka e brendshme, thuajse intime, që farkëtohet vetëm nën ndikimet mjaftueshëm të forta për të depërtuar tek ne.

Shpeshherë arti, muzika dhe letërsia na ndihmojnë të kuptojmë se si funksionon qenia njerëzore. Dua të përmend Eugjen de Rastinjakun, rioshin e famshëm balzakian, i cili



sipas mendimit tim modest është shembulli më i mirë për të treguar se karakteri definohet nga reagimi ynë gjatë gjithë jetës dhe se ndikimet e një magnitudo të fuqishme kanë bukë në tjetërsimin e tij. Rastinjaku është simbol i të riut ambicioz, plot ëndrra, i etur për pozitë e dashuri, por altruist dhe i ndjeshëm në thelb. Gjatë gjithë romanit në njihemi me përpjekjet dhe planet e tij për ta katapultuar veten në botën mondane pariziene.

Ai përballlet me ndikimin e Votrenit, Delfinës, Anastasisë dhe shumë personazheve të tjerë. Herë e gjejmë të neveritur nga sjellje dhe reagime të caktuara, herë të tjera e gjejmë në buzën e mohimit të vetvetes dhe vënies në dyshim të natyrës së karakterit të tij. Kaq të forta mund të jenë shkulmet e ndikimit të jashtëm. Kjo ndodh me shumë mundësi nga fakti se ai ende nuk kishte formuar një karakter të mirëidentifikueshëm dhe Parisi sa po ia vështirësonte punën.

Ama, në fund të veprës, Rastinjaku i jep një premtim vetes se nuk do të lejonte kurrë që Parisi të ndryshonte qenësinë e tij.

Rastinjaku na tregon se karakteri është totalisht personal, një shqisë e madhe e cila na jep dorë ose na pengon në realizimin e vetvetes. Karakteri është e mira dhe e keqja e njeriut. Gjithsesi karakteri ngelet një miks i të dhënës me të parën. Në vitet përcaktuese të formimit të tij, karakteri është një fëmijë që rrotullohet dhe thith si sfungjer shprehje, sjellje, idioma, qëndrime, mendime, koncepte, reagime, perceptime, shqisa dhe transformohet më pas në identitetin tonë. Ky është sipas mendimit tim, momenti kur brenda njeriut ndodh një shpërthim i vogël që të bën të kuptosh se në një farë mënyre të caktuar t'i ndihesh mirë me veten.

Ama, nuk duhet mohuar se e keqja e të gjithës qëndron në faktin se në vitet kur njeriu duhet të zgjedhë me kujdes ndikimet në formësimin e tij, ai është vetëm fëmijë dhe një fëmijë, sado i ndjeshëm të jetë trunisht ndaj ndjesive të para intuitave, ngelet fëmijë dhe një sfungjer i madh përthithës.

Ka në fakt edhe një shembull mjaft të bukur që tregon të kundërtën e besimit tim, se karakteri formësohet tërësisht nga ndikimet e jashtme që përjeton njeriu. Vendoseni një fëmijë brenda një dhome me një dritare dhe lëreni atë fëmijë të jetojë për njëzet vite, në periudha të gjatat kohore me njerëz të ndryshëm. Do të shikoni se pas një moshe të caktuar (6 ose 7), ai do të fillojë të reagojë ndaj sjelljeve të caktuara, pak më vonë (10-11) do të mohojë në mënyrë kategorike me forcë dhe p argument karakterin e tij dhe karakterin tuaj, pas disa vitesh (14-17) do të kërkojë dëshpërimisht një përgjigje se cili është, pse është si është, do të qahet për karakterine vet dhe do të ndikohet pashmangshëmrisht nga çdo mendim mbi të dhe do të përpiqet t'i shpëtoje esencës së vërtetë të vetvetes. Edhe pse në thelb ai e ka krijuar karakterin në vegjëli, një pjesë e

karakterit të tij do të formohet në rininë e hershme dhe nën ndikimin e personave të ndryshëm për njëzet vite, karakteri i tij do të jetë i vështirë për tu definuar. 18-20 vjeç do të karakterizohet nga një siguri e rreme se di gjithçka i duhet për të filluar jetën, por vetëm kur të mbushë 30 vjeç do të fillojë të jetojë realisht më një karakter që i janë dashur 30 vjet për ta ndërtuar nën influencat e njerëzve të ndryshëm.

Ky shembull provon se njeriu krijon njeriun.

Si përfundim, karakteri është kompleks sa i thjeshtë, i përcaktueshëm sa intim, i pëlqyeshëm sa edhe relativ. Ai ngelet në vetvete edhe për personat që nuk e pranojnë, frika më e madhe e njeriut sepse sot karakteri lidhet me stigmën e zhargonit: "I tillë person, ha/nuk ha bukë sot!"

Karakterit është i falur, por ai është asgjë nëse ne nuk e ndërtojmë bazuar në njerëzit dhe ndikimin e tyre tek ne, ndikime që thjeshtësisht nuk mund të ndalohen.



## 13. Koha na ka borxh momente...

*Iris Fani*

Është e mundur të gjesh paqe në vetvete duke anashkaluar jetën? Të kërcesh me të njëjtën këngë që dikur qaje, a mund të quhet ky një progres? Të bindësh veten se duhet të vdesësh pak nga pak për të kuptuar se je ende gjallë, a është kjo e drejtë? Të pyesësh veten nëse asgjë nuk ka kuptimin e diçkaje? Të jetosh në kujtime duke shpresuar se mund të kthehesh në retrospektivë? Të besosh se gjurmët e tua nuk do t'i zbehë pluhuri? Të shohësh shembjen e murit të kalasë që kalove tërë jetën duke e ndërtuar? Të numërosh sekondat, minutat, orët, ditët, muajt dhe vitet e shpenzuara për të arritur një qëllim dhe të mos jesh në gjendje të numërosh momentet e shpenzuara me njerëzit e zemrës? Ndodh kjo për shkak se janë aq të shumta këto të dytat sa nuk mund t'i përmbledhësh në shifra, apo sepse të lëndon fakti se sa pak kohë ke shpenzuar për to?

Të kesh frymëzim për të pamundurën dhe të rrethohesh nga e paimagjinuara, të kesh fjalë që qajnë dhe lot që flasin, të kesh guximin të ndryshosh dhe të zbulosh vetveten dhe nëse përfundimi do të të thyente, të gjesh forcë të qëndrosh kur prirja është për t'u larguar, të gjesh guximin të kthesh forcën në kryefjalë dhe të gjesh forcë të mos i dorëzohesh kohës dhe as fatit. T'i vësh flakën zemrës e të mos e djegësh dot. Të besosh se koha është thjesht një iluzion? Të kesh frikë nga vdekja, por të mos jetosh jetën. Të goditesh fort nga një shkëndijë, sa të rrit dhe të lodh, të jep ndjesinë se nuk ka përfundim... A është kjo vetëm një lojë fjalësh, apo kështu është me të vërtetë realiteti?

Kam udhëtuar në labirintet e mërzhisë për të zbuluar vetveten. Kam menduar se kisha gjithçka, por në të vërtetë nuk kisha asgjë. Kam kuptuar se as nata nuk është më e zezë se një mungesë. Kam kuptuar se në tre pika shpirt, malli është prangosës. Malli është si një dhembje gjithmonë e hidhur dhe e pranishme, nyja e të gjithë zbrazëtisë, e vetmja ndjesi që nuk mund të shkulet kurrë nga shpirti im. Kam kuptuar se të qeshësh dhe të jesh i lumtur nuk është e njëjta gjë. Kam kuptuar se nuk mund të kërkosh për përjetësinë, por mund të tentosh të krijosh diçka që do të jetë e përjetshme. Kam kuptuar se gjërat e vogla, momentet e vogla, oh jo, ato nuk janë aspak të vogla.

Dikush më tha se në jetë asnjëherë nuk merr atë që meriton, por atë për të cilën negocion dhe që prej asaj dite kam kuptuar se nuk mund të jesh asnjëherë i lumtur, por mund të jesh mjaftueshëm i guximshëm për të ndjekur lumturinë. Kam kuptuar se personat e duhur janë ata që dinë si të të përqafojnë shpirtin, do të thotë kjo se po kërkon shumë vallë?? Kam kuptuar se shumë njerëz kanë si qëllim të gjejnë personin e duhur, por duke harruar se ato duhet të jenë të duhurit pikësëpari. Kam kuptuar se me sa shumë njerëz



ndihem kur jam vetëm dhe sa bosh ndihem e rrethuar nga njerëzit, sepse kam kuptuar sa e rëndësishme është të arrish të seleksionosh, kush është realisht aty për ty dhe kush është momentalisht aty për ty... As miq, as armiq thjesht të huaj me kujtime të njëjta. Askush nuk e di se ku banon me të vërtetë njeriu... Njerëzit mendojnë se jam aty kur më shohin trupin, por trupi është thjesht shtëpi lëvizëse, bosh shpeshherë, sepse shpesh nuk jam brenda. Ndonjëherë kam fshehur ndjenjat dhe nga vetvetja, ndoshta ndodhte kjo, sepse doja të anashkaloja përballjen me realitetin. Shkruaja poema në zemrën time herë me vargje mërzie dhe herë me vargje të cilat lëshonin aromë lulësh. Tek ecja rrugëve nuk i njihja më njerëzit, e kisha të vështirë të kuptoja nëse isha unë ajo që kishte ndryshuar totalisht, ata, apo të dyja palët kishim devijuar në rrugëtime të ndryshme. Ndhem e inspiruar nga frika për të qenë si të tjerët... Ndoshta po jetojmë në atë gjeneratën ku përbërësi përçmon enën. Unë kundërshtoj botën, dinjiteti im kundërshton realitetin... E dhimbshme për t'u përmendur dhe akoma më e trishtë për t'u besuar. Nuk e di nëse duhet të vazhdoj të besoj në faktin se rrjetet sociale na kanë marrë momente të pakthyeshme, na kanë bërë të humbasim sensin e qëllimeve, kohës, standardeve dhe ç'është më e rëndësishmja sensin e të vërtetës. Ndonjëherë ndihem e humbur në një realitet që nuk ekziston. Të jetosh dhe të ndihesh i gjallë nuk është e njëjta gjë. Të sfidosh qëllimet dhe majat, është si të kuptosh se sado që të ngjitesh lart qielli është i paarritshëm. Ndoshta nuk mund të ndryshojmë atë që na është dhënë në jetë, por jam e bindur se mund të ndryshojmë atë që kërkojmë nga jeta...

Çfarë mund të kërkojë vërtet nga jeta vallë? Komfortin? Unë nuk do të dëshiroja kurrë të rrethohesha nga komforti i tepërt në jetën time. Dua të rrethohem nga sfidat dhe nga aspiratat për të arritur të paimagjinueshmen, ato dëshirat që më bëjnë të ndihem jo vetëm një pikë në oqean, por i tërë oqeani në një pikë. Nëse nuk luan me zjarrin atëherë ku është e bukura e flakës? Më duhet të pranoj se shumë gjëra në shumë pak kohë më kanë bërë t'i jap jetës komplet një tjetër kuptim, është e habitshme, por e vërtetë. Kur shoh mbrapa kuptoj sa shumë që kam ndryshuar.

Më parë isha shumë e trembur nga fakti se po ndryshoja, por tani ndihem e lumtur që kam ndryshuar dhe madje mund të them se këtë radhë ndryshimi është aq i thellë sa të lë përshtypjen se janë dy persona të ndryshëm brenda një trupi. Pikërisht qëllimi për të luftuar komfortin më solli në këto rezultate. Nëse përpiqem të analizoj veprimet e mia të mëparshme kuptoj se sa shpirt ekspresiv, por ndoshta jo shumë analitik kam patur, kuptoj se në të shumtën e rasteve e shikoja gotën gjysmë bosh, nuk mund të them se jam penduar për gjërat që kanë ndodhur në të kaluarën, sepse ato më detyruan të arrija në një pikë sa të bezdisesh nga fryma që më rrethonte dhe nga mendimet që më udhëhiqnin, gjë që më bëri të zhvishesha nga mendimet dhe të filloja të ecja atëherë kur gjunjët nuk më mbanin. Zgjedha ta bëja të kaluarën si xhirimin e një filmi që papritur



pritej në mes. Shikoja një fortunë përballë meje, por nuk stepesha të kaloja përmes saj. Për një moment u bëra rrahja që u shkëput prej natyrës.

Fillova të dashuroj tingullin e gjurmëve të hapave që largoheshin nga vendi që nuk përkisnin. Fillova të kuptoj rëndësinë e privatësisë dhe dinjitetit. Fillova të kuptoj rëndësinë e standardeve dhe të qëllimeve, si dhe fillova të kuptoj se ne jemi larg vetëm kur mungon sinqeriteti. Fillova të kuptoj se nuk mund të kesh asgjë përpara teje që mund të të pengojë të jesh vetvetja. Njohuria të jep një fuqi shumë të madhe, por karakteri të jep respektin për vetveten.

Njerëzit mendojnë se gjëja parësore është respekti që fitojnë të tjerët për ty, harrojnë se në fillim duhet të kesh respekt për vetveten. Ndonjëherë mund të jetë më e lehtë të shpërbësh një atom se një paragjykim. Fjalët i tret era dhe kujtimet i merr lumi. Jetojmë të gjithë nën të njëjtin qiell, por nuk kemi të njëjtat horizonte. Në fund të ditës isha unë ajo që zgjedha të notoja kundër rrymës. Kam zgjedhur të jem si hëna, shumicën e rasteve jo e plotë, por asnjëherë nuk ngurron të ndriçojë...

Ndoshta në jetë mund të blesh shumë gjëra, por jo lumturinë dhe ç'është më e keqja kurrë nuk mund të blesh kohën... Ah koha, sa emocione të mëdha përmban dhe sa fjalë e shkurtër që është. Këtu qëndron hipokrizia e fakti se asnjëherë nuk munda të pranoj kur ishte hera e fundit, momenti i fundit, ai moment që nuk ka më një kthim, ai moment është kthyer si një plagë në gjysmëshpirt, ajo plagë për atë cilën zgjedh të mos flas kurrë dhe përpiqem ta zbeh lehtë duke e anashkaluar... Kuptova se koha ikën, por ajo lë pas gjurmë, lë pas kujtime.

Nuk ka kuptim të jetosh në kujtime e t'i lësh faqet me lumenj lotësh, ndaj u zgjova nga kujtimet për të jetuar. Në momentet më të vështira kanë qenë ato kujtimet që më kanë bërë të kuptoj se si jeta është e mbështetur në formimin e një pazlle dhe kuptova se ato kujtime do të mbeten gjithnjë brenda meje. Tepër ironik fakti që kam nënvlerësuar gjërat që kisha dhe mbivlerësuar gjërat që mund të kisha. Nëse e analizojmë në një aspekt tjetër mund të shohim se dhe shkëmbi që të krijon idenë se është aq i fortë dhe i patundshëm me kalimin e kohës ndryshon...

Mendoj se nuk mund të gjesh paqe duke anashkaluar jetën. Shumë mendime më pushtojnë me shpejtësinë e erës dhe kur i kam të gjitha përgjigjet, pyetja ime ndryshon... Çdo fjalë ka sekuenca dhe çdo heshtje gjithashtu. Të dish të lexosh heshtjen e një njeriu mendoj se vlen më shumë se të kuptosh fjalët e tyre, pasi heshtja godet më tepër. Të dish të lexosh sytë e dikujt mendoj se është një art, është aftësia e të paturit mundësinë e zberthimit të personalitetit, është si të zbulosh nënkuptimet e metaforave. Më duken më kuptimplota ato biseda në të cilat sytë flasin dhe heshtja pushton. Është e njëjta gjë si të gjesh paqe në stuhi.



Të numërosh yjet duke shpresuar se mund të dalësh në një përfundim të saktë. Këtë ndjesi më jep mua leximi. Leximi është një mënyrë e imja e arratisjes, kam krijuar një folezë përmes faqeve të librave të ndryshëm. Më bëjnë të jetoj në ato poema për të cilat nuk mund të shkruash. Ato momente në të cilat fjalët nuk mjaftojnë për t'i përshkruar... në burg.

-Në burg?

-Eh.

-Po për sa?

-Përjetë më duket...

-Me çfarë të kapën?

-Me ANDRRA!!!!!!



**Bashkia Elbasan.** *Bashkia e re e Elbasanit kufizohet në veri me bashkinë Tiranë, në lindje me bashkinë Librazhd, në jug-lindje me bashkinë Prrenjas, në jug-perëndim me bashkinë Gramsh dhe në perëndim me bashkitë Cërrik dhe Peqin. Kryeqendra e bashkisë është qyteti i Elbasanit. Sipas Censurit të vitit 2011, kjo bashki numëron 141,714 banorë, ndërsa sipas Regjistrimit Civil ajo numëron një popullsi prej 205,892 banorësh dhe me densitet prej 236.11 banorë për km<sup>2</sup>. Bashkia e Elbasanit ka një sipërfaqe prej 872,03 km<sup>2</sup>. Kjo bashki përbëhet nga 13 njësi administrative. Bashkia e re ka nën administrimin e saj një qytet dhe 116 fshatra e cila është një nga më të mëdhatë në Shqipëri, si dhe një nga bashkitë më komplekse për t'u administruar.*



ADRESA: BASHKIA ELBASAN, RR. "Q.STAFA"  
TEL: +355 54 400152  
EMAIL: [BASHKIAELBASAN@ELBASANI.GOV.AL](mailto:BASHKIAELBASAN@ELBASANI.GOV.AL)  
WEB: [WWW.ELBASANI.GOV.AL](http://WWW.ELBASANI.GOV.AL)  
FACEBOOK: [@ELBASANBASHKIA](https://www.facebook.com/ELBASANBASHKIA)

